



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:164180

Datë: 30.05.2022

Numri i dokumentit: 03069456

E.nr.880/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbaremore të kreditorit B.S nga fsh .., Komuna e Shtimes, të cilin e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Qendra për Integrim dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik, me seli në Shtime, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 30.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbaremore në lëndën **E.nr.880/21**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.880/21, të datës 21.07.2021, e ka caktuar përmbaremin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Qendra për Integrim dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik, me seli në Shtime, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.1816/20, të datës 29.03.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbaremit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 05.11.2021, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 853.25 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbaremore në këtë çështje juridike përmbaremore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.880/21, më datë 30.05.2022

GJYQTARI
Faton Ajvazi